



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE


KONFIRMIM DEPOZITIMI DOKUMENTACIONI NË GJYKATË KUSHTETUESE

Në datë 10 . 03 .2026, ora 11:21 u depozitua në Gjykatën Kushtetuese dokumentacioni me dërgues 114 Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe objekt:/lëndë: shtimin e objektit të harkimit në çështjen 11(7)
dt. 12.11.2025

Përgjegjëse e protokoll-arkivit në Gjykatën Kushtetuese

Alketa Spahiu

Nënshkrimi (vula e sekretarisë)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 10 / 03 /2026

K Ë R K E S Ë

PËR SHTIMIN E OBJEKTIT TË KËRKIMIT NË CËSHTJEN 11 (J), DATË 12.11.2025

DREJTUAR: GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KËRKUES: JO MË PAK SE 1/4 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Kryetari i Grupit Parlamentar të PD z. Gazment Bardhi, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij, si dhe avokat Marash Logu, me adresë: “Kryesia e Kuvendit, Grupi Parlamentar i PD, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë”; dhe email gazmentbardhi@gmail.com dhe/ose marashlogu@gmail.com.

SUBEJKTE TË INTERESUARA: KUVENDI I SHQIPËRISË, me adresë Kryesia e Kuvendit, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

OBJEKT: Në kërkesën nr. 11 (J), datë 12.11.2025 që është në shqyrtim nga Gjykata Kushtetues, shtohet objekti si më poshtë:

1. Në pikën 1 të kërimit, shtohet:

“1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit: “(iii) Për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural).”

2. Pas pikës 3, shtohet pika 4:

“4. Deklarimi i vendimit nr. 12/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural)”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 77, 78, dhe 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*);

Neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

Nenet 43/b, pika 2, 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*);

Ligji nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar (*ligji nr. 8891/2002*).

E nderuar znj. Kryetare e Gjykatës Kushtetuese,

Të nderuar zonja dhe zotërinj anëtarë të Gjykatës Kushtetuese

Ne, jo më pak se 1/4 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, pasi përmes vendimeve të Kuvendit të Shqipërisë nr. 77/2025 dhe nr. 78/2025, na është mohuar kompetenca dhe e drejta kushtetuese e parashikuar nga neni 77 i Kushtetutës, kemi paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese kërkesën nr. 11 (J), datë 12.11.2025, bazuar në faktet, rrethanat dhe provat shoqëruese të asaj kërkeje.

Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkeje në Gjykatën Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë (nënkupto shumicën parlamentare), ka vijuar t'i mohoi subjektit kushtetues inicues (nënkupto pakicën parlamentare) të kërkesës nr. 11 (J), të drejtën kushtetuese të kontrollit parlamentar përmes ngritjes së Komisioneve Hetimore, duke vijuar mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Konkretisht, Kuvendi i Shqipërisë ka refuzuar kërkesa nr. 3117 prot., datë 28.10.2025, “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural)” të 1/4 së deputetëve përfaqësues të pakicës parlamentare, duke miratuar Vendimin nr. 12/2026, datë 3.2.2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural)”.

Duke qenë se jemi i njëjti subjekt kushtetues – 1/4 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të pakicës parlamentare, dhe duke qenë se jemi përpara të njëjtit kërkim kushtetues – zgjidhje e mosmarrëveshjes së kompetencës, në mbështetje të nenit 43/b, pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, ku specifikohet se: *“Kërkuesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit ose heqjen dorë nga kërkesa”*, si dhe pikës 2, të nenit 30 të Rregullores së Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese “Për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese”, paraqesim me shkrim këtë kërkesë për shtimin e objektit të kërimit, bazuar në faktet, rrethanat dhe provat¹ shoqëruese shtesë, si më poshtë vijon:

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. 45 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë (përfaqësues të pakicës parlamentare) që përbëjnë jo më pak se 1/4 të deputetëve të Kuvendit, kanë paraqitur kërkesën nr. 3117 prot., datë 28.10.2025, “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural)”².

2. Hetimi parlamentar i kërkuar lidhet me verifikimin e zbatimit të ligjit nr. 30/2016 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”

¹ Lista e provave bashkëlidhur:

1. Kërkesa nr. 3117 prot., datë 28.10.2025, “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural)”.

2. Urdhri e Kryetarit të Kuvendit për thirrjen e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve në datën 05.11.2025, ora 14:00.

3. Procesverbali i mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve të datës 05.11.2025, ora 14:00.

4. Urdhri i datës 30.01.2026 i Kryetarit të Kuvendit për thirrjen e mbledhjes së seancës plenare në datën 03.02.2026, ora 10:00.

5. Procesverbali i seancës plenare të datës 03.02.2026.

6. Vendimi nr. 12/2026 i Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural)”.

² 202511031210070200Kërkesë nr prot 3117.pdf

(IPARD)”³, ku parashikohet mbështetje financiare në shumën 94 milionë euro për fermerët shqiptar, ku financimi ndahej në masën 75% nga Bashkimi Evropian dhe 25% nga Qeveria shqiptare.⁴

3. Hetimi parlamentar për zbatimin e ligjit nr. 30/2016 është i domosdoshëm për shkak se pas një hetimi gjithëpërfshirës nga zyrtarët evropianë të OLAF, rezultuan disa shkelje shumë serioze qoftë gjatë fazës së dhënies së granteve, ashtu edhe gjatë zbatimit të projekteve. Konkretisht këto shkelje përfshinin: i) aplikantëve u kërkohej të paguanin një pjesë të konsiderueshme të grantit pranë një kompanie lokale konsulence; ii) kontratat jepeshin pa garë reale ose përmes një gare të manipuluar nëpërmjet paraqitjes së ofertave fiktive; dhe iii) çmimet ishin të fryra dhe u shkelën rregullat kontraktuale.⁵

4. OLAF i rekomandoi Komisionit Evropian që ta konsideronte një pjesë të financimit të thirrjes së parë dhe të dytë për programin IPARD II në shumën 33 milionë euro të papranueshme, çka më pas solli edhe pezullimin e këtyre fondeve. Po ashtu, u pezulluan edhe fondet e programit IPARD III në shumën 112 milionë euro. Pra, si rezultat i shkeljeve shumë serioze të detyrimeve ligjore dhe kontraktuale, të cilat OLAF i konsideroi si “*kriminale*” dhe “*korruptive*”, fermerëve shqiptar iu mohua mundësia për të përfituar 112 milionë euro mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian, në kuadër të programit IPARD III, pjesë e Marrëveshjes Kuadër IPA III.

5. Gjetjet dhe konkluzionet që rezultuan nga hetimi i kryer nga zyrtarët evropianë, OLAF ia përcolli zyrtarisht institucioneve shqiptare. Ndërkohë, brenda përgjegjësisë së veta, drejtësia shqiptare ka deklaruar se është duke hetuar faktet penale në raport me këtë marrëdhënie të paligjshme⁶. Në këtë kuptim, për kërkuesin është e rëndësishme që edhe Kuvendi i Shqipërisë të kryerjë një hetim administrativ mbi zbatimin e ligjit, pasojat e ardhura nga shkelja e ligjit dhe marrja e masave për mospërsëritjen e shkeljeve në të ardhmen apo forcimin e mekanizmave të kontrollit për zbatimin e ligjit.

³ <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/dbfc75ca-db13-4892-baf7-beecf34e6685>

⁴ <https://azhbr.gov.al/programi-ipard/>

⁵ https://ec.europa.eu/olaf-report/2023/investigative-activities/preventing-undue-expenditure_en.html#serious-misuse-of-eu-pre-accession-agricultural-funds

⁶ Shiko përgjigjen e Kreut të SPAK gjatë raportimeve në Komisionin e Ligjeve më datë 15 Tetor 2025

6. Kërkesa e argumentuar ku paraqiten edhe faktet dhe grupfaktet që përbëjnë shkakun e këtij hetimi parlamentar, ka përcaktuar qartë objektin dhe detyrimin e Komisionit për të respektuar parimet kushtetuese. Kështu, kërkesa dhe projektvendimi shoqërues⁷, përcaktojnë qartë se:

“II. Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij: (i) Kontrollin e zbatimit të Marrëveshjes Kuadër IPA II dhe Marrëveshjes Sektoriale IPARD II ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian; (ii) Verifikimin e procesit të përzgjedhjes, miratimit dhe financimit të aplikimeve fituese të fondeve të programit IPARD II; (iii) Analizimin e respektimit të detyrimeve ligjore dhe kontraktuale nga përfituesit e fondeve IPARD II në fazën e zbatimit të projekteve; (iv) Identifikimin e shkeljeve dhe parregullsive të mundshme në administrimin e fondeve të programit IPARD II, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale; (v) Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet ligjore nëpërmjet miratimit, korrigjimit apo plotësimit të legjislacionit relevant për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në administrimin e ndihmës financiare të Bashkimit Evropian dhe fondeve publike, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe mbikëqyrjes parlamentare; (vi) Të angazhohet për të propozuar për miratim të gjitha masat e nevojshme ligjore që të shmangen në të ardhmen situatat e evidentuar në raportin e hetimit të Zyrës së Bashkimit Evropian kundër Mashtrimeve (OLAF), dhe që mbrojnë interesat financiare të BE-së nga aktivitetet ilegale, duke propozuar masat konkrete që janë të nevojshme që institucionet përgjegjëse të Bashkimit Evropian të rekomandojnë zhbllokimin e fondeve për Shqipërinë për programin IPARD III.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit.”.

7. Në bazë të urdhrit të Kryetarit të Kuvendit, në mbështetje të nenit 7, pika 6; nenit 12, pika 2; nenit 25 dhe nenit 98 të Rregullores së Kuvendit, si dhe ligjit nr. 8891/2002, Kryetari i Kuvendit thirri mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve në datën 05.11.2025, ora 14:00, me këtë rend dite: “Shqyrtimi i kërkesës së një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë në administrimin e

⁷ Shiko projektvendimin shoqërues të kërkesës - 202511031210070200Kërkesë nr prot 3117.pdf

fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural)”.

8. Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të zhvilluar më datë 5.11.2025, mazhoranca nuk ngriti asnjë pretendim për objektin e punës së Komisioneve Hetimore, cka nënkupton që ajo nuk mund të mohonte të drejtën e opozitës për ngritjen e një Komisioni Hetimor. Gjatë diskutimeve në këtë mbledhje⁸, përfaqësuesit e mazhorancës ngritën disa pretendime për formulimet/retorikën apo citimet e përdorura në kërkesën e deputetëve të opozitës. Konkretisht, përfaqësuesit e mazhorancës në Konferencën e Kryetarëve u shprehën:

“Taulant Balla – Nuk dua të hyj fare në çështjet që prekin thelbin e kërkesës, megjithëse konstatoj disa problematika në mënyrën e prezantimit të saj. Shoh që në faqen 3 thuhet: “Gjatë raportimit në Komisionin e Ligjeve drejtuesi i SPAK-ut pranoi se aktualisht çështja është në hetim, në bashkëpunim me prokurorët europianë” dhe indeksohet, në kuptimin tregohet që ky informacion është marrë në link-un “Telegraf.al” “Politikë”/ “Abuzimet me fondet e IPARD-it; përfituese grupet kriminale dhe të afërmit e politikanëve”. Ndërkohë, këtë mund të na e indeksoni te procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Ligjeve. Kjo është në këndvështrimin e formës, sepse do të kaloj edhe te përmbajtja. Kur kemi thënë që prej vitit 2010, pastaj edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që pa dyshim kërkesat duhet të jenë me fakte dhe grup-faktesh, por kur edhe për ngjarjet që ndodhin në Kuvendin e Shqipërisë nuk i referohen një dokumenti zyrtar të Kuvendit të Shqipërisë, siç është procesverbali i Komisionit të Ligjeve, por i referohen një shkrimi në një gazetë, ku kuptohet qartë që nuk është shqetësim nevoja për të hetuar përdorimin e tyre, sepse duket nga titulli i gazetës, atëherë mendoj që kërkesa humbet rrugës dhe pastaj del qartazi se cili është qëllimi i vërtetë i kërkesës. Tjetra, zoti Kryetar, në qëndrimet tona, tanimë konsistente, sa i përket gjithçkaje që ka shprehur Gjykata Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë duhet të respektojë pavarësinë e institucioneve që Kushtetuta i ka ngarkuar me hetimin. Ne nuk mund të jemi organe, që vendosemi mbi ato. E treta, që është më e rëndësishme se të gjitha, për shkak të intensitetit shumë të madh të kërkesave të kësaj natyre që vijnë nga ju, ne në Konferencën e Kryetarëve nuk kemi autoritetin për të vendosur për këtë çështje, por është seanca plenare që duhet të vendosë. Duke qenë se na duhet kohë që ta shikojmë deri në seancën që do të vendoset për këtë çështje, do t’ju kërkoja që pozicionin tonë për sa i përket kësaj kërkeje ta shprehim në seancën plenare.”⁹.

“Taulant Balla – Zoti Kryetar, prandaj e sqarova që nenet 7 dhe 8 të ligjit janë të qarta, pra nga momenti që mbërrin kërkesa. Ne jemi mbledhur këtu për të diskutuar për kërkesën e nismëtarëve, për përbërjen e komisionit, si dhe për caktimin e datës së miratimit në Kuvend. Kjo është detyra jonë. Unë për kërkesën dhashë disa shembuj; shembujt e tjerë do t’i jap në seancën plenare. Konferenca e Kryetarëve ka marrë kompetencat e Byrosë së dikurshme, kur është shkruar ligji në vitin 2002. Atëherë Kuvendi kishte Byro, Byroja është gjë tjetër, tani është Konferenca e Kryetarëve, apo duhet ta ndryshojmë këtë, meqë do të ndryshojmë ligjin? Ne duhet të shikojmë në seancën plenare, që ta vendosë seanca me shumicën e anëtarëve. Sido që të vendosim ne këtu, do të shikojmë në seancë. Unë mendoj, zoti Kryetar, në seancën e datës 19, që të marrin edhe pak kohë, se jemi brenda 15-ditëshit që na përcakton ligji duke filluar nga sot, të vendosim për këtë çështje. Pra, kur Konferenca e Kryetarëve nuk arrin të përcaktojë elementet e mësipërme me konsensus, atëherë këto çështje i adresohen seancës plenare. Kërkesa paraqitet për miratim në seancë plenare jo më vonë e 15 ditë nga dita e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve. Pra, nga sot deri më datën 19, kemi 15 ditë, pastaj të diskutojmë atje dhe të vendosim.”¹⁰.

⁸ 202512020909009752Procesverbal, datë 5.11.2025.pdf

⁹ Shiko faqen 39-40 të Procesverbalit të mbledhjes datë 5.11.2025, ora 14:00 të Konferencës së Kryetarëve. - 202512020909009752Procesverbal, datë 5.11.2025.pdf

¹⁰ Shiko faqen 43 të Procesverbalit të mbledhjes datë 5.11.2025, ora 14:00 të Konferencës së Kryetarëve. - 202512020909009752Procesverbal, datë 5.11.2025.pdf

9. Ndrkohë, pavarësisht qasjes tërësisht bashkëpunuese të kërkuesve, gjatë diskutimeve në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 5.11.2025¹¹, ku u kërkua bashkëpunimi për riformulime konkrete apo propozime alternative, gjë që nuk u bë nga mazhoranca. Kjo provonte tërësisht që shqetësimet e ngritura në Konferencën e Kryetarëve nga ana e shumicës parlamentare, ishin thjesht një alibi për të mohuar të drejtat kushtetuese të pakicës parlamentare.

10. Gjatë seancës plenare të datës 3.2.2026, mazhoranca mbajti këtë qëndrim për kërkesën për ngritjen e Komisionit Hetimor dhe me forcën e kartonit rrëzoi të drejtën e opozitës për ngritjen e Komisionit Hetimor, përmes miratimit të vendimeve të Kuvendit nr. 12/2026, pa argumentuar arsytet në pikëpamje të respektimit të Kushtetutës dhe pa ofruar asnjë formulim alternativ:

“Blendi Klosi - E dëgjova me vëmendje kolegun dhe folklorin e tij, që pa dyshim është për t’u përshëndetur. I gjithë fjalimi i tij ishte për arsyen pse ne, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, nuk duam që ky komision të ngrihet, ashtu siç e tha kolegu. Pra, ne, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, refuzojmë ngritjen e një komisioni hetimor për programin e IPARD-it, pasi kemi bindjen se ato fonde janë jashtëzakonisht të rëndësishme për fermerin shqiptar, pasi kemi bindjen se përgjigjet e pyetjeve që kolegu bëri gjatë fjalës së tij vijnë nëpërmjet fondeve të BE-së, që të ndihmojnë bujqësinë shqiptare të ecë edhe një hap më tej. Më lejoni të them shumë qartë se ky nuk është një refuzim i transparencës, nuk është shmangie nga përgjegjësia, përkundrazi, është mbrojtje e një procesi institucional, që aktualisht është në zhvillim në dy drejtime kryesore. Së pari, drejtpërsëdrejti me Komisionin European dhe institucionet, të cilat kanë kërkuar të ketë një rrugë bashkëpunimi, analize, studimi, faktmbledhëse, e pastaj një vendimmarrje për të zhbërë problematikat dhe për të hapur fondet e reja të IPARD III. Së dyti, po aq seriozisht vijon edhe puna e organeve të drejtësisë të vendit tonë dhe të Komisionit European, që janë po aq korrekte, po aq rigorozë, po aq të thelluara në të gjithë procesin e hetimit të kësaj problematike. Janë fakte që ne duhet t’i përmendim. Së pari, programi IPARD ka qenë një ndër instrumentet më të rëndësishme në mbështetje të bujqësisë shqiptare. Me 75% financim nga BE-ja dhe 25% mbështetje nga qeveria shqiptare janë realizuar plot 540 investime nga Veriu në Jug. Në çdo zonë tonën elektorale dhe në çdo njësi që ne përfaqësojmë ka një investim të qenësishëm të mbështetur nga programi i IPARD-it, që ka ndihmuar në të gjitha aspektet e shtrirjes së veprimtarisë bujqësore, që nga serrat moderne, mekanika bujqësore, pikat e grumbullimit, agroturizmat, fabrikat e përpunimit, kantinat e verës, investimet në energji të rinovueshme, në të gjitha aspektet, duke krijuar qindra vende të reja pune, kapacitete të reja prodhuese për bujqësinë shqiptare falë këtyre investimeve, duke zgjeruar shpërndarjen e këtij produkti jo vetëm në Shqipëri, por edhe eksportimin jashtë vendit tonë. Pa dyshim që shqetësimet që ngriti kolegu i opozitës ekzistojnë, por vijnë nga një ekspansion i jashtëzakonshëm i produktit shqiptar, sepse në ato tregje që ka më shumë konkurrencë, më shumë vëmendje, pa dyshim që ka edhe problematika. Pra, të gjitha këto na bëjnë të besojmë se këto investime kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishme për bujqësinë shqiptare. të Së dyti, e themi fare qartë se ka pasur problematika. Ne nuk fshihemi nga pasja e problematikave. OLAF-i ka kryer një hetim administrativ për periudhën 2021-2023 dhe raporti u është përcjellë organeve të mëtejshme, që konkretisht është DG AGRI, autoriteti i vetëm me të cilin shteti shqiptar komunikon zyrtarisht për ta çuar procesin përpara. Autoritetet shqiptare kanë dorëzuar observacionet dhe një plan masash korrigjuese, të cilat janë rakorduar me përfaqësuesit e BE-së: është kontraktuar dhe përfunduar një auditim i jashtëm i pavarur, janë marrë masa për rikuperim fondesh në rastet e identifikuar, është rikonstruktuar agjencia e zbatuese e këtij programi, janë forcuar kontrollet, është digjitalizuar aplikimi, është rritur databaza përkatëse për të pasur gjithmonë e më shumë informacion. Pra, qartazi, procesi nuk është në errësirë, por është në monitorim të drejtpërdrejtë, jo vetëm të institucioneve shqiptare, por edhe të institucioneve të BE-së. Këtu është i gjithë thelbi i qëndrimit tonë edhe në kuadër të komisionit që ju kërkoni. Pra, komisioni hetimor do të ishte një proces paralel politik mbi një çështje që aktualisht po trajtohet teknikisht me ata që e financojnë, e dënojnë dhe e mbajnë këtë proces, që është Komisioni European. Sot Shqipëria është në një fazë shumë delikate të këtij procesi, ku pritet përfundimi dhe mbyllja e programit IPARD II, për të hapur më pas procesin e IPARD III. Çdo hap i kontaminuar

¹¹ Shiko faqen 40-43 të Procesverbalit të mbledhjes datë 5.11.2025, ora 14:00 të Konferencës së Kryetarëve. - 202512020909009752Procesverbal, datë 5.11.2025.pdf

politikisht në këtë fazë do të krijojë probleme të kësaj marrëdhënie dhe do të prishë një diskutim kaq të gjatë, të punuar me kaq kujdes, kaq shumë të monitoruar dhe kaq shumë delikat, si dhe do të pengojë ecjen përpara të procesit. Së treti, argumenti se komisioni hetimor do të sillte më shumë transparencë nuk qëndron në rastin konkret, sepse IPARD-i monitorohet nga struktura të përcaktuara në marrëveshjen ndërkombëtare: nga DG AGRI nga Komiteti i Monitorimit, nga autoriteti auditues, nga zyrtari kombëtar autorizues; ka audit të jashtëm, ka raport periodik, ka masa korrigjuese me afate të përcaktuara. Pra, të gjitha ato që kolegu i tha me folklor janë të shkruara në këtë raport institucional me BE-në dhe të gjitha auditimet shkencore tashmë janë zhvilluar, janë realizuar dhe pritet të ecet përpara. Komisioni hetimor do të shtonte një mekanizëm kontrolli më të fortë në rastin e një debati politik, por do të ishte jashtëzakonisht shumë i keq sa i përket realizimit të masave konkrete. Pra, ne kemi shumë më tepër detyrime karshi qytetarëve, fermerëve të përmendur, karshi të gjitha atyre halleve të bujqësisë shqiptare, të cilat i pranojmë, që ta menaxhojmë ashtu siç duhet këtë proces. Pra, parregullsitë e evidentuara të trajtohen me masa konkrete, çdo përgjegjësi individuale të ndiqet nga institucionet kompetente, vendase apo të huaja, fondet të rikuperohen sipas rregullave dhe IPARD III të fillojë pa vonesë. Ky është objektivi ynë, për këtë objektivi ne jemi votuar dhe këtë objektivi ne do ta vëmë në zbatim. Prandaj, qartë, thjesht dhe për ta mbyllur këtë diskutim, ne jemi pro transparencës, pro llogaridhënies dhe kundër që të bëhet spektakël politik në kurriz të fermerëve shqiptarë.”¹²

11. Për këtë arsye, është krijuar një konflikt kompetencash mes pakicës prlamentare (nënkupto 1/4 e deputetëve kërkues) dhe Kuvendit të Shqipërisë (nënkupto shumicën parlamentare) që duhet të zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese, duke vendosur: “Detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit dhe deklarimin e vendimit nr. 12/2026 të Kuvendit të Shqipërisë si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”. Kjo për faktin se, sipas nenit 77 të Kushtetutës dhe vendimeve të shumta të Gjykatës Kushtetuese:

- Komisionet hetimore janë mjet efektiv kontrolli që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit, të cilat ngrihen për çështje të veçanta, të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit. **Ngritja e komisioneve hetimore parlamentare, kur kërkohet nga një e katërta e deputetëve, është e detyrueshme.**
- Në një regjim parlamentar nuk është shumica ajo që vëzhgon qeverisjen, por kjo konsiderohet tashmë si detyrë e opozitës. Prandaj kjo e drejtë e pakicës për të ngritur komisione hetimore, e garantuar me Kushtetutë, **duhet të mbetet gjithmonë e paprekur**¹³.
- Është e vërtetë që Gjykata Kushtetuese ka pohuar se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk mund të jetë e pakufizuar. **Kufizimi i saj lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese**¹⁴. Gjykata Kushtetuese ka identifikuar një kusht gjatë procesit parlamentar, sipas të cilit **shumica parlamentare, në rastet kur pretendon se çënohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e**

¹² Shiko faqen 110-111 të Procesverbalit të seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë të datës 3.2.2026, ora 10:00 - 202602201324219246Procesverbal, datë 3.2.2026.pdf

¹³ Shih vendimin nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese

¹⁴ Shih vendimin nr. 57, datë 23.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese

hetimit, është e detyruar të propozojë formulime alternative, duke i dhënë mundësinë pakicës të riformulojë kërkesën e saj¹⁵.

Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese,

12. Rrëzimi me votë politike të mazhorancës i një të drejte kushtetuese të opozitës, e bën rolin e deputetëve të saj në Kuvend, jo thjesht të papërfillshëm, por mbi të gjitha fasadë e një normaliteti të rremë që vret cdo ditë rregullat dhe standardet minimale të parlamentarizmit demokratik. Kjo ka vënë seriozisht në pikëpyetje nevojën e prezencës së opozitës në Kuvend, por nga ana tjetër dëmton interesin publik për shkak se deputetët nuk ushtrojnë dot përgjegjësitë dhe funksionet e tyre. Nëse opozita nuk diskuton dot në Kuvend çështje që kanë interes për qytetarët, nëse nuk ushtron dot kontroll ndaj qeverisjes, nëse nuk shtyn dot përpara miratimin e ligjeve/amendamenteve në interes të qytetarëve, nëse nuk përfilllet në të drejtat e saj që ia njeh Kushtetuta e Shqipërisë, atëherë roli i saj në Kuvend është thjeshtë formal duke mos përmbushur përgjegjësitë e veta në një shoqëri demokratike dhe duke dëmtuar kështu sistemin e kontrollit dhe balancës mes pushteteve, si garanci për funksionimin demokratik të shtetit shqiptar.

13. Baza Ligjore, argumentet për legjitimitimin e kërkuarit, si dhe argumentet lidhur me të drejtën e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një Komisioni Hetimor, janë të njëjta si në kërkesën nr. 11 (J), datë 12.11.2025 që është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

II. PËRMBLEDHJE E ARSYEVE PËR TË KUNDËRSHTUR PËRPARA GJYKATËS KUSHTETUESE VENDIMIN NR. 12/2026 TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË DHE PËR TË KËRKUAR ZGJIDHJEN E KONFLIKTIT TË KOMPETENCAVE

14. Në mënyrë të përmbledhur vendimi nr. 12/2026 i Kuvendit të Shqipërisë, bien ndesh me nenet 7, 77, 124 dhe 132 të Kushtetutës, për shkak se:

14. 1. Një e katërta e deputetëve përbën subjekt kushtetues, të cilit vullneti i shumicës parlamentare nuk mund t'i kufizojë ushtrimin e kompetencës kushtetuese për ngritjen e komisionit hetimor

¹⁵ Shih vendimin nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese

parlamentar. Pengimi i kësaj kompetence përbën konflikt kushtetues kompetence dhe legjitimon kërkuesin për të kërkuar zgjidhjen e saj.

14.2. Kuvendi duke vendosur mospranimin e kërkesës për ngritjen e një Komisioni Hetimor ka cenuar pushtetin e pakicës parlamentare të sanksionuar në nenin 77, pika 2 të Kushtetutës. E drejta e pakicës për të kërkuar ngritjen e komisionit hetimor është e pakufizuar nga vullneti i shumicës dhe sipas parashikimit kushtetues, Kuvendi është i detyruar të caktojë komision hetimi.

14.3. Kërkesa e pakicës parlamentare ka pasur për objekt hetimin parlamentar për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi, me qëllim që të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit apo korrigjimit të ligjeve të veçanta si dhe për të parandaluar dhe eliminuar fenomenet negativ të konstatuar nga OLAF në të ardhmen.

14.4. Qëllimi i punës së Komisionit Hetimor konsiston në një hetim të tillë që përfshihet qartësisht në funksionin e pushtetit legjislativ (mbikëqyrja për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik), pa cenuar kompetencat e pushteteve të tjera.

14.5. Kërkesa për ngritjen e Komisionit Hetimor parlamentar respekton konceptin kushtetues “çështje e veçantë”, pasi në këtë koncept përfshihen çështje të hetimit të trajtuara në aspektin e kontrollit dhe zbatimit të ligjit, të njohjes dhe verifikimit të një ngjarjeje, a veprimtarie dhe që nxisin iniciativat për propozime e miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shtetin dhe shoqërinë.

14.6. Objekti i hetimit të Komisionit Hetimor, fokusohet në një çështje konkrete, çështje për të cilat ekzistojnë të dhëna dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për një veprimtari të kundërligjshme. Për më tepër, indicia për shkeljen e ligjit është një hetim i pavaruar i kryer nga një institucion ndërkombëtar sic është OLAF.

14.7. Kuvendi ka vendosur mosngritjen e një Komisioni Hetimore, pa dhënë asnjë argument kushtetues, pa ngritur asnjë pretendim për objektin e hetimit, dhe mbi të gjitha pa ofruar asnjë “formulim alternativ”.

15. Lidhur me antikushtetutshmërinë e vendimit nr. 12/2026 të Kuvendit dhe që është shkaku i krijimit të mosmarrëveshjes së kompetencave midis pakicës parlamentare dhe Kuvendit të Shqipërisë, për shkak të mungesës së argumenteve kushtetuese të mazhorancës për rrëzimin e kërkesës për ngritjen e një Komisioni Hetimor, ritheksojmë se mazhoranca në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 5.11.2025 nuk ngriti asnjë pretendim lidhur me objektin e hetimit. Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ngriti disa shqetësime mbi retorikën apo citimet e përdorur në kërkesë, duke sjellë shembuj konkretë. Të gjitha këto “shqetësime” nuk përbëjnë shkak kushtetues për rrëzimin e kërkesës për ngritjen e Komisionit Hetimor. Është e drejtë e kërkuarit që të citojë në kërkesë të dhëna publike, zyrtare apo jo zyrtare, për të mbështetur qëndrimin e tij.

16. Ndërkohë në seancën plenare të Kuvendit të datës 3.2.2026, mazhoranca ngriti të tjera pretendime, të cilat nuk kanë asnjë bazë kushtetuese dhe që mund të përmbliidhen si më poshtë:

16.1. **Pretendimi 1:** Ne, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, refuzojmë ngritjen e një komisioni hetimor për programin e IPARD-it, pasi kemi bindjen se ato fonde janë jashtëzakonisht të rëndësishme për fermerin shqiptar, pasi kemi bindjen se përgjigjet e pyetjeve vijnë nëpërmjet fondeve të BE-së, që të ndihmojnë bujqësinë shqiptare të ecë edhe një hap më tej.

16.2. **Pretendimi 2:** Ky nuk është një refuzim i transparencës, nuk është shmangie nga përgjegjësia, përkundrazi, është mbrojtje e një procesi institucional, që aktualisht është në zhvillim në dy drejtime kryesore. Së pari, drejtpërsëdrejti me Komisionin Europian dhe institucionet, të cilat kanë kërkuar të ketë një rrugë bashkëpunimi, analize, studimi, faktmbledhëse, e pastaj një vendimmarrje për të zhbërë problematikat dhe për të hapur fondet e reja të IPARD III. Së dyti, po aq seriozisht vijon edhe puna e organeve të drejtësisë të vendit tonë dhe të Komisionit Europian, që janë po aq korrekte, po aq rigorozë, po aq të thelluara në të gjithë procesin e hetimit të kësaj problematike.

16.3. **Pretendimi 3:** Autoritetet shqiptare kanë dorëzuar observacionet dhe një plan masash korrigjuese, të cilat janë rakorduar me përfaqësuesit e BE-së: është kontraktuar dhe përfunduar një auditim i jashtëm i pavarur, janë marrë masa për rikuperim fondesh në rastet e identifikuar, është rikonstruktuar agjencia e zbatuese e këtij programi, janë forcuar kontrollet, është digjitalizuar aplikimi, është rritur databaza përkatëse për të pasur gjithmonë e më shumë informacion. Pra, komisioni hetimor do të ishte një proces paralel politik mbi një çështje që aktualisht po trajtohet teknikisht me ata që e financojnë, e dënojnë dhe e mbajnë

këtë proces, që është Komisioni European. Sot Shqipëria është në një fazë shumë delikate të këtij procesi, ku pritet përfundimi dhe mbyllja e programit IPARD II, për të hapur më pas procesin e IPARD III. Çdo hap i kontaminuar politikisht në këtë fazë do të krijojë probleme të kësaj marrëdhënie dhe do të prishë një diskutim kaq të gjatë, të punuar me kaq kujdes, kaq shumë të monitoruar dhe kaq shumë delikat, si dhe do të pengojë ecjen përpara të procesit. Prandaj, qartë, thjesht dhe për ta mbyllur këtë diskutim, ne jemi pro transparencës, pro llogaridhënies dhe kundër që të bëhet spektakël politik në kurriz të fermerëve shqiptarë.

17. Këto pretendime antikushtetues nuk qëndrojnë për disa arsye:

17.1. Së pari, pretendimi i parë se fonde janë jashtëzakonisht të rëndësishme për fermerin shqiptar, nuk është argument për mosmiratimin e kërkesës, por përkundrazi konfirmon qëndrimin e kërkuar që jemi përpara një “cështje të vecantë dhe rëndësishme” për interesin publik.

17.2. Së dyti, pretendimi i dytë se mqs po heton Komisioni European apo organet e drejtësisë së Shqipërisë, nuk duhet të hetojë edhe Kuvendi i Shqipërisë, nuk qëndron. Komisioni European heton brenda fushës së vet të veprimtarisë dhe për pjesën e projektit që është financuar prej tij në masën 75%, ndërkohë është Kuvendi i Shqipërisë që ka ratifikuar marrëveshjen dhe ka miratuar financimin e projektit në masën 25 %. Fakti që Komisioni Hetimor po heton përforcon nevojën që edhe Kuvendi i Shqipërisë të hetojë brenda sferës së vet të kompetencave dhe të ushtrojë përgjegjësinë e vet kushtetuese të kontrollit të zbatimit të kësaj marrëveshje (ratifikuar me ligj). Kuvendi i Shqipërisë madje është autoriteti që ka përgjegjësinë për të koordinuar hetimin me Komisionin European dhe për të marrë masa për të shmangur përsëritjen e fenomeneve.

Nga ana tjetër, organet e drejtësisë përmbushin kompetencat e tyre kushtetuese, që nuk përkojnë me kompetencat kushtetuese të kontrollit parlamentar nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Ashtu sikurse ka qartësuar tashmë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, fakti që cështja po hetohet edhe nga organet e drejtësisë, nuk përbën pengesë kushtetuese për ushtrimin e kontrollit parlamentar, për shkak se ato ndjekin qëllime dhe objektiva të ndryshme. Komisioni Hetimor do të ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, procesit të rregullt ligjor, prezumimit të pafajësisë, paanshmërisë dhe respektimit të jetës private.

17.3. Së treti, edhe pretendimi i tretë që autoritetet shqiptare kanë dorëzuar observacionet dhe një plan masash korrigjuese, të cilat janë rakorduar me përfaqësuesit e BE-së, nuk përbën argument për mosmiratimin e kërkesës për ngritjen e Komisionit Hetimor, por përkundrazi përforcojnë nevojën për kontroll parlamentar edhe të atyre masave. Autoritetet përgjegjëse të pushtetit ekzekutiv kanë ushtruar përgjegjësitë e tyre, të cilat janë objekt kontrolli parlamentar.

Hetimi parlamentar, ndryshe nga sa shprehet mazhoranca, nuk është *“një proces paralel politik mbi një çështje që aktualisht po trajtohet teknikisht me ata që e financojnë”* apo *“hap i kontaminuar politikisht në këtë fazë do të krijojë probleme të kësaj marrëdhënie dhe do të prishë një diskutim kaq të gjatë”*, por është një përgjegjësi dhe funksion kushtetues i Kuvendit të Shqipërisë, që synon garantimin e intersit publik.

Komisionet hetimore që ngrihen për këtë qëllim në kuptim të nenit 77 të Kushtetutës, janë një mjet që i shërben pikërisht ushtrimit të kontrollit parlamentar dhe ato janë instrument i rëndësishëm i parlamentit për mbledhjen e informacionit për çështje të veçanta, me qëllim arritjen e përfundimeve të caktuara, që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit e të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit. E drejta e Komisionit Hetimor për kryerjen e hetimeve do të realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që mbulojnë deputetët, si përfaqësues të popullit dhe avokatë të interesit publik, për zbardhjen e plotë të kësaj çështjeje. Dobishmëria e këtij hetimi konsiston pikërisht në nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, duke ndihmuar në evidentimin e problemeve dhe mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës.

18. Lidhur me kushtetutshmërinë e objektit të hetimit parlamentar, argumentet kushtetuese të përgjithshme janë dhënë në kërkesën tonë nr. 11 (J), datë 12.11.2025 që po shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

19. Në shtesë të tyre, argumentojmë se në kërkesën për ngritjen e Komisioneve Hetimore, por edhe në tekstin e projektvendimit që shoqëron këto kërkesa, është specifikuar shprehimisht se: *“III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së*

pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit.”.

19.1. Shtuar kësaj, edhe vetë mazhoranca nuk ka ngritur asnjë pretendim se objekti i hetimit të kërkuar cenon parimet kushtetuese, apo shkon përtej rolit kontrollues të Kuvendit të Shqipërisë. Po në këtë aspekt, parimet duhen respektuar gjatë fazave të ndryshme të realizimit të qëllimit të hetimit: në çastin e formulimit të objektit (fakt që provohet se ka ndodhur); gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komisionit (projektvendimi e parashikon shprehimisht një detyrim të tillë); dhe në hartimin e konkluzioneve përfundimtare të hetimit.

19.2. Nga ana tjetër, kërkesa dhe objekti i hetimit parlamentar të kërkuar përmbush të paktën tre kushte kryesore: 1) çështja ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat Kuvendi është i autorizuar të marrë masa ligjore; 2) objekti i hetimit fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; 3) ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështje, për të cilën është i nevojshëm hetimi. Për pasojë kërkesa dhe objekti i hetimit përmbush të gjitha kushtet kushtetuese¹⁶ për t’u pranuar.

19.3. Objekti i hetimit, i parashtruar në mënyrë të qartë e të saktë, përmban fakte ose tërësi faktesh, nga të cilët merr shkas hetimi parlamentar dhe shpjegon se çfarë kërkohet të hetohet. Veç kësaj, objekti i hetimit është përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme, kusht ky që kërkohet për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave themelore, të parimit të ndarjes së pushteteve si dhe të kompetencave të kufizuara që disponon një komision hetimor¹⁷.

19.4. Objekt i hetimit parlamentar në Komisionin Hetimor të kërkuara i referohet një çështje që përmbush kriterin e veçantisë. Sic ka përcaktuar edhe Gjykata Kushtetuese, në parim “çështje e veçantë”, objekt i hetimit parlamentar, është një çështje me rëndësi të veçantë shtetërore/publike. Lista e këtyre çështjeve me rëndësi/interes të madh shtetëror/publik nuk mund të jetë shteruese, por duhet të përcaktohet rast pas rasti. Gjykata Kushtetuese është shprehur se “një çështje” që në aspektin kushtetues mund t’i nënshtrohet hetimit parlamentar, përbëhet nga

¹⁶ Shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

¹⁷ Shih vendimin nr.22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese

fakte apo rrethana, të cilat përfshihen në objektin e veprimtarisë së Kuvendit dhe për të cilat ekziston një mosmarrëveshje. Në këtë kuptim, çështja është manifestuar përpara marrjes së një vendimi përkatës nga ana e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor. Për pasojë, plotësohet kërkesa kushtetuese që komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston në fakt një çështje në kuptimin kushtetues dhe jo për të verifikuar nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen¹⁸. Në rastin konkret abuzimet me fondet IPARD janë konstatuar nga një agjenci e specializuar europiane - OLAF, dhe kanë ndodhur dhe ekzistojnë fakte dhe të dhëna që justifikojnë hetimin.

19.5. Qëllimi i ngritjes së Komisionit Hetimor përputhet me kompetencat kushtetuese të Kuvendit, pra me të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, në rastin konkret nga ana e administratës shtetërore. Po në këtë aspekt, objekti nuk përmban pasaktësi apo paqartësi të dukshme në mënyrën e formulimit të tij pasi shpjegohen faktet që duhet të hetohen. Është kompetencë e Kuvendit, në rastin konkret e pakicës parlamentare, të vlerësojë interesin publik për çështjet që kërkon të hetohen.

19.6. Në këtë mënyrë, qartësisht ekziston një çështje e veçantë, domethënë një çështje e një rëndësie të veçantë publike, për të cilën Kushtetuta nuk ndalon Kuvendin që, në funksion të veprimtarisë së tij ligjvënëse, të ngrejë komision hetimi, të tillë që mund të ngarkohen me hetimin e aktivitetit të shtetit ose institucioneve vendore, pra për mënyrën si kryejnë institucionet përkatëse shtetërore ose vendore funksionet e tyre të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje¹⁹.

19.7. Në rastin konkret, me vendimin nr. 12/2026, Kuvendi nuk ka miratuar kërkesën e deputetëve të pakicës parlamentare për ngritjen e një Komisioni Hetimor, me një “arsyetim” që nuk lidhet me objektin e punës së këtij komisioni, apo për shkak se ka konstatuar se është në kundërshtim me nenin 77 të Kushtetutës, si dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Shih vendimin nr.22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese

¹⁹ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.22, datë 05.05.2010 dhe nr.20, datë 04.05.2007

19.8. Nga materialet e referuara në këtë kërkesë dhe që gjenden edhe bashkëlidhur²⁰, konstatohet se mazhoranca nuk ka ngritur asnjë pretendim mbi cënimin nga kërkesa të standardeve kushtetuese. Edhe gjatë shqyrtimit të kërkesës në fjalë në seancën plenare të Kuvendit të datës 3.2.2026, vërehet se diskutimi mbi ngritjen e Komisionit Hetimor është reduktuar thjesht në një paraqitje të ndryshme të rrethanave nga përfaqësuesi i pakicës dhe ai i shumicës parlamentare, por pa përmbushur mazhoranca detyrimin e saj: (i) të evidentimit të standardeve kushtetuese që cenohen nga objekti i hetimit; apo (ii) pa formuluar asnjë propozim alternativ. Më pas është kaluar në votimin e kërkesës, ku qartësisht mazhoranca kishte shprehur vullnetin politik për rrëzimin me votë të një të drejte kushtetuese të deputetëve të pakicës parlamentare. Me vendimin nr. 12/2026, Kuvendi nuk ka miratuar kërkesën e deputetëve të pakicës parlamentare për ngritjen e Komisionit Hetimor.

19.9. Evidentohet qartësisht se gjatë debatit parlamentar, diskutimet në Konferencën e Kryetarëve dhe në seancën plenare në Kuvend nuk janë zhvilluar në drejtim të arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet palëve lidhur me objektin e hetimit, deri në marrjen e një vendimi. Kjo për përgjegjësi të plotë të mazhorancës, sepse deputetët e pakicës në mirëbesim, shqetësimet e mazhorancës së shprehur në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, i morën seriozisht dhe kërkuan bashkëpunim²¹. Ndërkohë në seancë plenare, mazhoranca solli pretendime të tjera tërësisht në mënyrë abuzive dhe antikushtetuese, vetëm e vetëm për të refuzuar ngritjen e Komisionit Hetimor. Shumica parlamentare në rastet kur pretendon se cenohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e hetimit (gjë që nuk e ka pretenduar në asnjë moment), është e detyruar të propozojë formulime alternative duke i dhënë mundësinë pakicës të riformulojë kërkesën e saj. Këtë detyrim mazhoranca nuk e ka përmbushur, duke provuar se refuzimi i kërkesës ishte vetëm vullnet politik për të refuzuar një të drejtë kushtetuese të deputetëve të opozitës.

19.10. Gjatë diskutimit parlamentar, arsyetimi i shumicës parlamentare është tepër i përgjithshëm dhe nuk jep shkaqet e vërteta për të cilat është vendosur rrëzimi i kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor. Nga diskutimi për shqyrtimin e kësaj kërkeje në Konferencën e Kryetarëve, në seancën plenare në Kuvend, sikurse u theksua më lart, vërehet se arsyeja e

²⁰ Pocesverbalet e mbledhjeve të organeve të ndryshme të Kuvendit gjatë procedurës parlamentare të shqyrtimit të kësaj kërkeje

²¹ Shiko faqen 40-43 të Procesverbalit të mbledhjes datë 5.11.2025, ora 14:00 të Konferencës së Kryetarëve. - [202512020909009752Procesverbal, datë 5.11.2025.pdf](#)

mospranimi të saj nuk lidhet me objektin e hetimit parlamentar, por me vlerësimin e rrethanave të përfshira në kërkesë apo me veprimtari të organeve apo institucioneve të tjera.

20. Për të gjitha sa më lart, është e provuar që debati parlamentar nuk ka pasur si orientim kryesor mbrojtjen e të drejtës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, por mohimin e saj. Për rrjedhojë, vendimi i Kuvendit nr. 12/2026, në këtë aspekt, nuk është e pajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

III. PËRFUNDIME

21. Bazuar në sa më sipër, lidhur me të drejtën e pakicës parlamentare për të iniciuar një kontroll parlamentar, ritheksojmë se ngritja e komisionit hetimor parlamentar, kur kërkohet nga pakica parlamentare, është e detyrueshme. E drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të vihet në diskutim. Kushtetuta “... ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit” dhe, mbi këtë bazë, Kuvendi “... ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit” kur kjo kërkohet nga pakica parlamentare.

22. Në përmbledhje të të gjitha fakteve dhe argumenteve të parashtruara në këtë kërkesë, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, vlerësojmë se:

- Është cenuar e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, e cila nuk mund të mohohet apo të kufizohet nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare. Ajo është një e drejtë kushtetuese që çon detyrimisht në ngritjen e komisionit;
- Në rastin konkret, objekti i hetimit të Komisionit Hetimor është në përputhje me natyrën e këtij komisioni, si dhe me kriteret dhe standardet kushtetuese të analizuara dhe trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese;
- Shkaku i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit duhet kërkuar të mohimi, nga ky i fundit (Kuvendi), i kompetencës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor me argumentin jokushtetues;
- Mazhoranca nuk ka bërë asnjë përpjekje dhe asnjë formulim alternativ në raport me objektin e hetimit.

PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të neneve 7, 77, 78, dhe 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 25 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; neneve 43/b, pika 2, 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar; dhe ligji nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar,

K Ë R K O J M Ë:

1. Pranimin e kërkesës për shtimin e objektit të kërkesës nr. 11 (J), datë 12.11.2025 që po shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, si më poshtë:

“ - Në pikën 1 të kërimit, shtohet:

“1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit: “(iii) Për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural).”.

- Pas pikës 3, shtohet pika 4:

“4. Deklarimi i vendimit nr. 12/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural)”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit: *“Për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural).”.*
3. Deklarimi i vendimit nr. 12/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i

Paraanëtarësimi për Zhvillimin Rural)”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

NË MËNYRË ALTERNATIVE

Nëse nga ana e Gjykatës Kushtetuese (Kolegji apo Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese), cmohet se nuk jemi në kushtet e aplikimit të nenit 43/b, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar; dhe për pasojë nuk pranohet pika 1 e kërimit në këtë kërkesë si më sipër, atëherë kërkojmë:

1. Regjistrimin e kësaj kërkesë si një kërkesë të re/të vecantë për shqyrtim nga ana e Gjykatës Kushtetuese, me objekt:

“1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit: “Për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimi për Zhvillimin Rural).”.

2. Deklarimi i vendimit nr. 12/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimi për Zhvillimin Rural)”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”.

2. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit: *“Për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimi për Zhvillimin Rural).”.*

3. Deklarimi i vendimit nr. 12/2026 të Kuvendit të Shqipërisë *“Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë dhe administrimin e fondeve të programit IPARD II (Instrumenti i Paraanëtarësimi për Zhvillimin Rural)”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”.*

Gjithashtu, në përfundim, për shkak të interesit publik që paraqet kjo çështje, kërkojmë përsheptimin e shqyrtimit të çështjes.

E nderuar Znj. Kryetare,

Në përmbajtje të kërkesës për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave dhe shfuqizimin e vendimit nr. 12/2026, kërkuessit kanë arsyetuar se vendimmarrja e Kuvendit sjell pasoja që prekin drejtpërdrejtë të drejtën kushtetuese të deputetëve të pakicës parlamentare (*jo më pak se një e katërta e deputetëve*) për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare. Kjo pasi nëpërmjet kësaj vendimmarrje, ngritja e komisioneve hetimore të Kuvendit është tërësisht në vullnetin e mazhorancës.

Hetimi parlamentar është jo vetëm një e drejtë e garantuar nga neni 77, pika 2, e Kushtetutës së Shqipërisë, e deputetëve të pakicës parlamentare, por edhe një prej funksioneve themelore të Kuvendit të Shqipërisë që lidhet me ushtrimin e kontrollit efektiv të qeverisjes. Funksioni kontrollues i Kuvendit është mishërimi në praktikë i parimit të ndarjes së pushteteve (*shih nenin 7 të Kushtetutës*), i cili garanton që Kuvendi të monitorojë dhe kontrollojë mënyrën se si pushteti ekzekutiv vë në zbatim kuadrin ligjor të miratuar nga Parlamenti. Që kontrolli i Kuvendit të jetë efektiv, Kushtetuta dhe Rregullorja i njohin atij një sërë mekanizmesh ligjorë, ku përfshihen seancat e pyetjeve, mocionet e debateve parlamentare, interpelancat, kërkesat për informacion, seancat dëgjimore etj. Ndër mjetet më të rëndësishme të kontrollit parlamentar mbi qeverisjen mbetet ngritja e komisioneve hetimore për shqyrtimin e çështjeve të veçanta, nëpërmjet të cilit kontrollohet zbatimi i ligjeve, nxirren përgjegjësitë institucionale, vlerësohet nevoja për rishikimin, ndryshimin apo miratimin e ligjeve, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shtetin dhe shoqërinë në të ardhmen. Sikurse theksohet në kërkesë, gjatë kësaj Legjislature, shumica ka refuzuar cdo mekanizëm kontrolli të kërkuar nga pakica parlamentare, duke asgjësuar në këtë mënyrë funksionimin demokratik të vetë Kuvendit dhe duke vënë në pikëpyetje nevojën e pjesëmarrjes në Kuvend të deputetëve të pakicës parlamentare, sa kohë mekanizmat e kontrollit që i njeh Kushtetuta refuzohen në mënyrë antikushtetuese me votë të mazhorancës në Kuvend.

Në kushtet kur çështja prek një prej të drejtave themelore që Kushtetuta e Shqipërisë i garanton deputetëve të pakicës parlamentare dhe një prej funksioneve themelore të Kuvendit, atë të

kontrollit efektiv të qeverisjes, është e kuptueshme se kjo çështje mbart një interes të veçantë publik, dhe shqyrtimi i saj duhet të bëhet me përparësi, siç ka vepruar Gjykata edhe në precedentin e mëparshëm lidhur me kërkesën e 1/5 së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për shfuqizimin e Ligjit nr. 106/2023 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 8891/2002 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”. Shqyrtimi me përparësi i kësaj çështjeje duhet të marrë në konsideratë edhe faktin se vonesat në realizimin e hetimit parlamentar në kërkesën e refuzuar mund të sjell pasoja në vetë efikasitetin e hetimit.

Po ashtu, Gjykata duhet të konsiderojë faktin se legjislatura parlamentare aktuale është në fillimin e saj, dhe vendosja e një standardi të shpejtë nga ana e Gjykatës Kushtetuese do të ndihmojë në realizimin në kohë të funksionit kontrollues të Kuvendit.

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në mbështetje të nenit 11, pika 2, gërma “c”, të Rregullores “Për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, përfundimisht,

K Ë R K O J M Ë

EDHE:

1. Pranimin e kësaj kërkesë procedurale.
2. Shqyrtimin brenda një afati sa më të shpejtë dhe me përparësi të kërkesës së 1/4 së deputetëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Deklarimin si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 12/2026 të Kuvendit të Shqipërisë.

Gjithashtu, Ne deputetët nënshkruar si më sipër **AUTORIZOJMË** për përfaqësimin tonë në këtë çështje: - Kryetarin e Grupit Parlamentar të PD **z. Gazment Bardhi**, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij, si dhe; - Avokat **z. Marash Logu**. Me adresë njoftimi: “Kryesia e Kuvendit, Grupi Parlamentar i PD, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë”; si dhe email: gazmentbardhi@gmail.com dhe/ose marashlogu@gmail.com.

Me konsideratë,

DEPUTETËT E KUVENDIT TË SHQIPËRISË:

1- Lech. Bano Buck

2- GAZMENT BARDH

3- Oerd Blykhesler Oerd

Blykhesler

4- Oerd Blykhesler Oerd

5- Elda Hoti

6- Saimir Lomeda

7- Glemur Nake

8- Tomor Ali 206

9. Kastriot Drolli Truol 2025

10- Kidal Kneka

11. Ledina Alolli

12- Meris Bollie

13. Jeta Shul

14. Eno Boro

15. Denisa Vata

16. Agron Gekmarkov

17. Keli Hoti

18- Romelina Liraj

19- Albene Vohshi

20- IS4E EOMAS

21- Hamey Moshe

22. Firi Grom ~~Re~~

23. duon Beei ~~du~~

24. Berast Klupen

25. Fizei Isuebi ~~Isuebi~~

26. Bonok Spalio ~~Spalio~~

27. Jude Tedsun

28. BELIND KELLIgi ~~Belind Kellu~~

29. Klodiana Sogjo ~~Sogjo~~

30. plendi Arimegi ~~Arimegi~~

31. Bujar Ledag ~~Bujar~~

32. Ina Zhupo

33. Zuts Berdeli ~~Berdeli~~

34. Xhela Mzi ~~Georgi~~

35. Mangulo Sula ~~Sula~~

36. Fiken ~~Fiken~~


37. Vanyel Jule ~~Vanyel~~


38. ED. PALONA ~~ED. PALONA~~

39. Jozefine Topelli ~~Jozefine~~


40. Arven ~~Arven~~

41. Iui kaso 

42. Beepom Vellbete 

43. Igei cara 

44. Lusame Bosi' 

45. Cotmanet Paulinont 

46. Tedi Bloxi 

47. ERISA XH/XHO 

48. Brunilob Hoxler 